

VENDIM
Nr. 524, datë 13.6.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E VITIT
2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Në programin 02120 “Forcat e luftimit”, në shpenzimet korente, të shtohet fondi 190 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë.

b) Në programin 02150 “Mbështetja e luftimit”, në shpenzimet korente, të pakësohet fondi 190 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha